



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 764/7 prot.

Datë 27.03.2026

V E N D I M

Nr. 435/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (*gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër*) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (*njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë*) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

Ankimues:

OE “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me NIPT K21710002J dhe me adresë, Rruga "Murat Toptani", Godina Eurocol, Kati 8, Tiranë, Shqipëri.

Autoriteti Kontraktor:

“Albanian Gas Services Company” Sh.A me adresë Rruga e Kosovarëve, Pallati Ndërpro shpk, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.01.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë

ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë 06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

II.2. Në datën 16.02.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 02.03.2026, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Advanced Business Solutions - ABS” Shpk	12,362,310.00 lekë	skualifikuar
2. “ALTEC” SHPK	15,170,000.00 lekë	skualifikuar

II.3.1. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, është skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, sipas arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor: “1. OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk ka disa mangësi në ofertën e tij pasi nuk plotëson kritererin e veçante të kualifikimit, shtojca 8, pikën 2.2.1 ku thuhet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Operatori ka dorëzuar disa fatura tatimore me ente private si me poshtë, te cilat nuk plotësojnë vlerën e kërkuar prej 40 % , pasi këto fatura kapin vlerën prej 56297 euro pa tvsh nderkohe qe duhet te plotësonte vlerën prej 68,288 euro pa tvsh.

Fatura nr.1246/ 2023 me vlere 18000 euro, fatura nr.2516/2025 me vlere 1566 euro, fatura nr. 2540/2025 me vlere 3000 euro, fatura nr.2015/2025 me vlere 5000 leke, fatura nr.2469/2025 me vlere 1566 euro, fatura nr. 2323/2025 ne vleren 12000 euro, fatura nr. 1970/2025 me vlere 3083 euro, Fatura nr. 2429/2025 me vlere 2500 euro, fatura 2402/2025 me vlere 1566 euro , Fatura 2593/2025 me vlere 1566 euro, fatura 31.07.2025 ne vleren 3800 euro si dhe fatura 2201/2025 ne vleren 3800 euro , fatura 2377/2025 ne vleren prej 3800 euro .

Ndërsa fatura tatimore me Nr. 1340, datë: 21/12/2023 ne vlerën 99561 euro ka shërbime te cilat nuk janë të ngjashme me zërat e objektit të prokurimit, por janë ne fushën e sistemit të luftës kundra zjarrit . dhe fatura nr. 1213/2023 ne vleren 148,636 euro e cila permban zera te cilat nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit pasi janë pajisje te ndryshme elektrike.

Gjithashtu OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk nuk plotëson edhe pikat 2.2.2, 2.2.3 2.2.4 te shtojcës 8 ku thuhet se:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015 e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001 e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

Certifikatat e paraqitura nga OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk përkatësisht Certifikata ISO 9001:2015 me Nr. AQS/Q/120032024, Certifikata ISO14001:2015 me Nr. AQS/A/161382026 si dhe Certifikata ISO 45001 me Nr. AQS/120052024, nuk kanë të përfshirë fusha e aktivitetit të këtyre ISO-ve objektin e prokurimit që është kërkuar të pikat e specituara.

Sa me sipër, mbështetur në nenin 92, pika 3 të LPP-së ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, KVO vlerëson ta skualifikojë ofertën e dorëzuar nga OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk.”.

II.5. Referuar raportit të auditit në SPE rezulton, se me 03.03.2026, është publikuar “Njoftim Anulimi” i procedurës së mësipërme të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 18, datë 09.03.2026.

II.6. Me datë 10.03.2026, është depozituar nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor,ku është administruar me nr. 764/2026 protokollin, datë 11.03.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6405 e OE “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, për procedurën e prokurimit sipër cituar, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 764/1 prot., datë 11.03.2026, lidhur me arsyet e kualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 9/8 prot., datë 18.03.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 764/2 prot., datë 19.03.2026, është dërguar në sistemin elektronik të ankesave, nga autoriteti

kontraktor, vendimi K.SH.A. së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.9. Nëpërmjet shkresës me nr. 9/8 prot., datë 18.03.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 764/3 prot., datë 24.03.2026, është dërguar me shërbim postar, nga autoriteti kontraktor, vendimi K.SH.A. së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 25.03.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 764/4 prot, shkresa me objekt “Kundërshtim administrativ ndaj aktit administrativ të autoritetit kontraktor”, dërguar në sistemin elektronik të ankesave, nga operatori ekonomik ankimues.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi se: *“OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk ka disa mangësi në ofertën e tij pasi nuk plotëson kritererin e veçante të kualifikimit, shtojca 8, pikën 2.2.1 ku thuhet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, pika 2.2. “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore*

të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.2. Në shtojcën 7, “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Ekzekutimit”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

-Akesi 1, ngarkuar në SPE;

- Shtojca 7

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP

	<i>Përshkrimi i shërbimit/ Service description</i>	<i>Sasia/ Quantity</i>	<i>Njësia/ Units</i>
A. Aktivitete Mirembajtjeje HVAC ne Rajonin KORCE/ HVAC Maintenance Activities in KORCE Region/			
	<p><i>Ndërhyrje e paplanifikuar: Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, orët shtesë, materialet e konsumueshme, mjetet e punes, etj. Koha e reagimit: 48 orë për të qenë në objekt nga momenti i njoftimit</i></p> <p><i>/ Unplanned intervention: Providing specialized personnel, including travel and accommodation expenses, extra hours, small consumables, hand tools, etc. Response time: 48 hours to be on site from notification.</i></p>	50	Ditë/ day
B. Aktivitete Mirembajtjeje HVAC ne Rajonin BERAT/ HVAC Maintenance Activities in BERAT Region			
	<p><i>Ndërhyrje e paplanifikuar: Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, orët shtesë, materialet e konsumueshme, mjetet e punes, etj. Koha e reagimit: 48 orë për të qenë në objekt nga momenti i njoftimit / Unplanned intervention: Providing specialized personnel, including travel and accommodation expenses, extra hours, small consumables, hand tools, etc.</i></p>	50	Ditë/ day

	<i>Response time: 48 hours to be on site from notification.</i>		
C. Aktivitete Mirembajtjeje HVAC ne Rajonin FIER/ HVAC Maintenance Activities in FIER Region			
	<i>Ndërhyrje e paplanifikuar: Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, orët shtesë, materialet e konsumueshme, mjetet e punes, etj. Koha e reagimit: 48 orë për të qenë në objekt nga momenti i njoftimit / Unplanned intervention: Providing specialized personnel, including travel and accommodation expenses, extra hours, small consumables, hand tools, etc. Response time: 48 hours to be on site from notification.</i>	50	<i>Ditë/ day</i>
D. Aktivitete të Përgjithshme të Mirëmbajtjes/ D. General Maintenance activities			
	<i>Rimbushje e paplanifikuar e gazit/ UNPLANNED - Refrigerant gas recharge</i>	200	<i>kg</i>
	<i>Analizë laboratorike për "Legionella"/ UNPLANNED - Sampling (legionella)</i>	40	<i>Moster/ Sample/</i>
	<i>Agjent pastrues për pajisjet HVAC (spiralet, etj.)/ Cleaning Agent for Equipment HVAC (coils ect)</i>	100	<i>kg</i>
	<i>Azot/ Nitrogen</i>	100	<i>liter</i>
	<i>Tuba bakri për sistemet HVAC me të gjithë aksesoret (dimensione të ndryshme)/ Copper Piping for HVAC Systems complete ëith Fittings (different dimensions)</i>	100	<i>kg</i>

Afatet e ekzekutimit: *Nga data e nënshkrimit te marreveshjes kuader deri me 31.12.2026.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, për përmbushjen e kriterit 2.2.1 në lidhje me shërbimet e mëparshme të ngjashme, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Nr.	Përshkrimi	Vlera pa Tvsh (monedha €)
1	Faturë elektronike nr. 1246/2023, datë 24.10.2023	xxxxxx
2	Faturë elektronike nr. 2516/2025, datë 27.11.2025	xxxxxx
3	Faturë elektronike nr. 2540/2025, datë 09.12.2025	xxxxxx
4	Faturë elektronike nr. 2015/2025, datë 19.02.2025	xxxxxx
5	Faturë elektronike nr. 2469/2025, datë 31.10.2025	xxxxx
6	Faturë elektronike nr.1340/2023, datë 21.12.2023	xxxxx
7	Faturë elektronike nr.2323/2025, datë 12.08.2025	xxxxx
8	Faturë elektronike nr.1970/2025, datë 21.01.2025	xxxxx
9	Faturë elektronike nr.2429/2025, datë 14.10.2025	xxxxxx
10	Faturë elektronike nr.1213/2023, datë 29.09.2023	xxxxx
11	Faturë elektronike nr.2402/2025, datë 30.09.2025	xxxxx
12	Faturë elektronike nr.2593/2025, datë 30.12.2025	xxxxx
13	Faturë elektronike nr.2307/2025, datë 31.07.2025	xxxxx
14	Faturë elektronike nr.2261/2025, datë 15.07.2025	xxxxx
15	Faturë elektronike nr.2377/2025, datë 18.09.2025	xxxx
Shuma total pa Tvsh (monedha €)		xxxx

<i>Fondi Limit pa Tvsh (monedha €)</i>	170,720.70
	40%
	68,288.28

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.1.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor 26 përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme, ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, për të fituar kontratën publike, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër. Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat e shërbimeve, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë kushtin e ë përcaktuar në nenin 41, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë se ka kryer shërbime të ngjashme me sukses të një ose disa kontratave në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që prokurohet. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, jo më të vogël se 40% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, nga operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në pikën III.1.3. fatura tatimore elektronike, ku evidnetohet sasia, njësia, përshkrimi i shërbimit të realizuar, vlera pa Tvsh e shprehur në monedhën euro. KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (ku Komisioni për këtë komponentë do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 3 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), komponenti vlerë (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.2.1 pra në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit përkatësisht 68,288 euro lekë) si dhe komponentit natyrë e ngjashme (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik me

objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre). Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për shërbime ligjvënësi në nenin 41 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i furnizimeve të ngjashme të mëparshme të realizuara dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK ka kryer furnizime të ngjashme me shërbimet e mirëmbajtjes të përshkruara në mënyrë të detajuar operaimi i tyre, në “Aneksin 1” të hartuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me elementin kohë, faturat tatimore elektronike (në fashën kohore 29.09.2023-27.11.2025), për operatorin ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, të realizuara me sektorin privat, me vlerë XXXX, (***Shuma total pa Tvsh***) (***monedha €***), e cila është realizuar me sukses, janë brenda afatit kohor 3 vjeçar, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës së procedurës objekt – ankimi, e cila është publikuar më datë 07.01.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në lidhje me elementin vlerë, për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlerat e realizuar me subjektet private është XXXXXX, (***Shuma total pa Tvsh***) (***monedha €***), e cila është realizuar me sukses, duke e tejkaluar vlerën e kërkuar sipas kriterit të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit (*Fondi Limit pa Tvsh (monedha €) 170,720.70 * 40% = 68,288.28 pa Tvsh (monedha €)*). Në lidhje me elementin natyrë e ngjashme, dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi faturat tatimore elektronike të cituara në pikën III.1.3, janë shërbime të ngjashme, pasi kemi të bëjmë me “Sisteme të kondicionimit”, në përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes së nenit 41 " Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve ", në pikën 3, ku ndër të tjera parashikohet: "4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”. Nga ana e ankimesit janë dorëzuar, fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara me subjekte private, duke shënuar, kohën, vlerën dhe sasinë e realizuar me sukses të tyre. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK vërteton, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat e parashikuar për kontratën objekt - shqyrtimi. Sa më sipër, nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni për kontratën e ngjashme të marrë në shqyrtim, rezulton, se vlera e përgjithshme e shërbimeve të ngjashme të realizuara në dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK është XXXXX, (Shuma total pa Tvsh) (monedha €), duke tejkaluar vlerën e shërbimeve të ngjashme të kërkuar nga autoriteti kontraktor jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit përkatësisht 68,288.28 pa Tvsh (monedha €), që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, duke e përmbushur këtë kriter. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë shërbimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në rastin konkret, operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me faturat tatimore elektronike të paraqitura, dëshmon se ka eksperiencë të ngjashme pasi këto fatura elektronike janë fatura shërbimi si ngritje dhe zhvillim sistemesh të teknologjisë së HVAC dhe një pjesë e tyre janë shërbime mirëmbajtje (rrjeti dhe sistemesh) me objekte të gjera veprimtarie, si dhe dëshmon se në realizimin e këtyre faturave elektronike me sektorin privat, ka patur shërbime të ngjashme jo vetëm në natyrë por edhe metodologji me një pjesë të rëndësishme të shërbimeve objekt prokurimi. KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave elektronike të realizuara me sektorin privat, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i shërbimeve në fatura tatimore elektronike dhe përshkrimeve të tyre si pjesë përbërëse, rezulton se faturat e shërbimeve të sipërcituara mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK me dokumentacionin e paraqitur pra faturat elektronike të realizuara me sektorin privat të sipërcituara, provon se ka kryer shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi shërbimet e paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, i cili si komponent kryesor të projektit është mirëmbajtja e sistemeve HVAC. Rrjedhimisht ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK. Sa më lart, nga verifikimi i shërbimeve të realizuara dhe dokumentacionit shoqërues të tyre, paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet, se operatori ekonomik ankimes ka kryer shërbime të

ngjashme me përshkrimin e shërbimeve, në Aneksin 1 të hartuara nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, por edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, referuar kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket eksperiencës së ngjashme, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, Komisioni konstaton, se ky i fundit përmbush kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor, për të paraqitur dokumentacion për punë të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të fondit limit përkatësisht 68,288.28 pa Tvsh (monedha €), që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: *“Certifikatat e paraqitura nga OE Advanced Business Solutions-ABS Shpk përkatësisht Certifikata ISO 9001:2015 me Nr. AQS/Q/120032024, Certifikata ISO14001:2015 me Nr. AQS/A/161382026 si dhe Certifikata ISO 45001 me Nr. AQS/120052024, nuk kanë të përfshirë fusha e aktivitetit të ketyre ISO-ve objektin e prokurimit që është kërkuar”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, “të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit më sipër, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 lëshuar nga AQSCert; nr. Certifikatës AQS/Q/120032024, me datë skadimi 03.04.2027, në gjuhën shqipe;
- Certifikatë e sistemit të menaxhimit mjedisor ISO 14001:2015 lëshuar nga AQSCert; nr. Certifikatës AQS/A/161382026, me datë skadimi 12.02.2029, në gjuhën shqipe;
- Certifikatë e sistemit të menaxhimit mjedisor ISO 45001:2018 lëshuar nga AQSCert; nr. Certifikatës AQS/S/120052024, me datë skadimi 03.04.2027, në gjuhën shqipe;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efëncën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.2.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” , e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.2.6. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

II.2.7. Në nenin 44 “Kërkesa e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një 30 mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37 të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/të barasvlershme me të ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Në rastin konkret, referuar dokumentave standarte të tenderit, konkretisht seksionit 2 Objekti i Kontratës pika 2.2 “Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar: “09322000-2; 42500000-1; 45331100-7; 71314310-8.”. Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në seksionin “Të tjera”, në rubrikën “Kodet CPV” përcaktohen grupi i kodeve, emërtimi i kodit CPV dhe Identifikimi i kodit CPV për procedurat e prokurimit elektronik. Sa më sipër, në grupin e kodeve “Pajisje ngrohje dhe ventilimi” bëjnë pjesë emërtimi i kodit 42500000-1 dhe identifikimi i kodit Shërbime për mirëmbajtjen e sistemit, që përputhet me kodin CPV të procedurës së prokurimit, ndërkohë që objekti i veprimtarisë për të cilën është certifikuar operatori ekonomik ankimues me certifikata ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 përfshin fushat “...Import-Eksport,

shërbime teknike, mirëmbajtje,....”, përkatëse ku secili nga këto objekte është i identifikueshëm me kodet respektive EA: 29, 33, 35, kode të cilat referuar VKM nr. 320, datë 28.05.2014 “Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të Revizionuara (Rev 2)” kanë në përbërje disa nënkategori apo klasa NACE, nga verifikimi i të cilave rezulton se secili nga kodet e sipercituara të certifikatave përfshinë objektin e procedurës së prokurimit, si psh klasat “33 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve” dhe “35 Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri i kondicionuar”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimes nuk qëndron, pasi certifikata ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik ofertues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, e plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.4 “*Kapacitetin teknik*” të shtojcës 9/2, “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi në fushënveprimin e këtyre certifikatave referuar kodeve është i përfshirë objekti i prokurimit, i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2, të Seksionit 2 “*Objekti i Kontratës*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018. Në këto kushte KPP gjykon, se operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikat 2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.4 “*Kapacitetin teknik*” të shtojcës 9/2 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: “1. *Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.* 2. *Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.* 3. *Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj.* 4. *Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit.* 5. *Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit.* 6. *Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti*

kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të kërkuar në dokumentat e tenderit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më lart, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK për përmbushjen e kriterëve në pikat 2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.4 “*Kapacitetin teknik*” do të konsiderohet i rregullt, duke plotësuar kështu këtë kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

Për më tepër, operatori ekonomik “Advanced Business Solutions – ABS” SHPK disponon licencë në ndërtim-zbatim (Licenca NZ.5990/5) pika e licensës NS-12-B “**Impiantet teknologjike, termike dhe kondicionimit**” si dhe në Formularin Përmbledhës së vetdeklarimit ka cituar se disponon staf teknik për realizimin e shërbimeve në mirëmbajtjen e sistemeve të HVAC. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimit publik nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions – ABS” SHPK për përmbushjen e kriterit më sipër, është në përputhje të plotë me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuar në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-73633-01-06-2026, me objekt Mirëmbajtja e Sistemit të HVAC (ngrohja, ventilimi dhe kondicionimi i ajrit) përgjatë ambjenteve të Gazsjellësit TAP” me fond limit 16,483,084 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh dhe/ose 170,720.70 (njëqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet pikë shtatëdhjetë) euro pa tvsh. Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë, datë

06.01.2026 është 96.55 lekë/Euro, zhvilluar në datën 16.02.2026 nga autoriteti kontraktor, “Albanian Gas Services Company” Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të kualifikojë operatorin ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

